



**KOMUNA E SHTIMES**  
*Municipality Shtime*  
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**  
*Department of Culture, Youth and Sports*

*Nr.09/08*

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore në Komunën e Shtimes.**

Në bazë të nenit 12 të Rregulorës MF Nr.04.2017mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masovizimin e sportit, projektet rinore apo kulturore.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:
  - 2.1. Të gjitha OJQ-të, Klubet Sportive të Komunës e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e sportit,
  - 2.2. Të gjitha OJQ-të, të Komunës e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe Rinisë.
3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e sektorit të kulturës, rinisë dhe sportit.
4. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: **33.500 euro**
  - 4.1. Shuma minimale e mbështetjes financiare është **200 €**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **8.000 euro**
4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë kalendarike, nga data 15.04.2021 deri më datë 30.04.2021
6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti 2 projekte në kuadër të kësaj thirrjeje por vetëm me një projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në dhjetor. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes publike.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunen e Shtimes.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe të sportit.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështjetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështjetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqën e internetit të Komunes së Shtimes. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën: Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës / zyra pritëse.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlersimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS.

Datë: 15.04.2021



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport  
Drejtori, Lumni Amrushi